



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË  
GJP "AUTOBUSKA STANICA" A.D. PRISTINA  
MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA

NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. GJP "AUTOBUSKA STANICA" A.D. MPE "BUS STATION" J. S.		
Nr. No.	22/3137	Data Date
		27.10 20 25
PRISHTINË/A		

## RAPORT FINANCIAR

Për periudhën Janar, Shkurt dhe Mars 2025  
TM1/2025

Prishtinë  
Qershor 2025

NPL "Stacioni i Autobusëve" SH.A  
Udhëheqëse e Shërbimit të Kontabilitetit  
Adelina Mustafa

Përmbajtja:

1.Hyrje

2.Shpenzimet e periudhës Janar, Shkurt dhe Mars 2025

3.Të hyrat e periudhës Janar, Shkurt dhe Mars 2025

4.Shpalosja e shpenzimeve dhe të hyrave

5.Pasqyra e të Ardhurave TM1/2025 dhe krahasueshmëria me TM1/2024

## **1. Hyrje**

Duke u bazuar në Ligjin 03L/087 për Ndërmarrjet Publike neni 14 mbi raportimet financiare të NP-ve, sektori financiar ka përgatitur raportin financiarë periodikë në baza tre mujore. Me këtë rast është përgatitur raporti financiar i NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A., Prishtinë, për periudhën TM1 2025 (Janar – Shkurt – Mars).

Ky raport në vete përfshin shpenzimet e periudhës raportuese si dhe të hyrat për periudhën raportuese duke i krahasuar me periudhën e vitit paraprak. Paraqitja e të hyrave dhe shpenzimeve janë indikator kyq të Ndërmarrjes të cilat i ndihmojnë menaxhmentit që të planifikojë dhe njëkohësisht të merr vendime të cilat ndikojnë në zhvillimin e ndërmarrjes.

## 2. Shpenzimet e periudhës Janar, Shkurt dhe Mars 2025

Shpenzimet janë marrë nga shenimet e kontabilitetit dhe si të tilla po i paraqesim më poshtë

<u>Përshkrimi</u>	<u>2025</u>
SHPENZIMET E ENERGJISË ELEKTRIKE	8,257.33
KOSTO E BILETAVE TE PERJASHTUARA	47,808.90
SHPENZIMET KOMUNALE TE UJIT	1,516.85
SHPENZIMET PER UDHTIME ZYRTARE	1,080.00
SHPENZIMET E MIREMBAJTJES SE OBJEKTIT	177.86
SHPENZIMET E MIREMBAJTJES SE MAKINAVE	309.09
SHPENZIMET E ADMINISTRATES 18%	959.55
SHPENZIMET E MBETURINAVE	4,550.83
SHPENZIMET E TELEFONIT	389.86
SHPENZIMET E INTERNETIT	226.37
SHPENZIME BANKARE DHE PROVIZIONE	304.65
SHPENZIMET E REPREZENTACIONIT TE KE	672.59
SHPENZIMET E DERIVATEVE	344.62
SHPENZIMET AD HOC	1.00
SHPENZIMET PER FOTOKOPJE/PRINTER	258.31
SHPENZIMET PER SHPALLJE	126.00
SHPENZIMET E PAGAVE	228,406.51
SHPENZIMET E KONTRIBUTIT PENSIONAL - PUNEDHENESI	11,491.47
SHPENZIMET PER DEZINFETIM TE HAPSIRAVE SAP	271.67
SHPENZIMET E MIREMBAJTJES SE ARKAVE FISKALE	170.76
SHPENZIMET E MIREMBAJTJES SE APARATEVE KUNDER ZJARRIT	12.71
SHPENZIMET OPERATIVE	17.12
SHPENZIMET PAJISJE PER IT	85.00
SHPENZIMETPER MIREMBAJTJE FURN.LAURAT	1,731.51
SHPENZIMET PER PROGRAM	1,499.90
SHPENZIMET PER UJE TE PIJES	315.41
SHPENZIMET E SANITARISE	463.29
SHPENZIMET PER TRANSPORT – TAXI	6.20
SHPENZIME DHURATA PER PUNTORE	50.00
SHPENZIME TE POSTAVE TE SHPEJTA	5.50
	<b>311,510.86</b>

## Krahasushmëria ne mes të shpenzimeve 2025 / 2024

Krahasushmëria e shpenzimeve bëhet në periudha të njëjta të viteve 2025 / 2024. Të dhënat e shpenzimeve janë marrë nga regjistrimet në kontabilitet dhe si të tilla i paraqesim në tabelën me poshtë.

<u>Përshkrimi</u>	<u>2025</u>	<u>2024</u>
SHPENZIMET E ENERGIJE ELEKTRIKE	8,257.33	4,948.86
Shpenzime Nxemjes	-	26.78
BILETAVE TE PERJASHTUARA	47,808.90	51,429.84
SHPENZIMET KOMUNALE TË UJIT	1,516.85	1,411.61
Shpenzime MirMbajteje Objektiv	177.86	42.29
Shpenzime Zyres	-	313.31
SHPENZIMET E MATERIALIT PER ZYRE	-	99.40
Shpenzimet e Mbeturinave	4,550.83	2,194.07
SHPENZIME PER UDHTIME ZYRTARE	1,080.00	-
SHPENZIMET E TELEFONIT	389.86	-
Shpenzimet e telefonit mobil	-	233.49
Shpenzimet e telefonit fiks	-	218.79
Shpenzime Interneti	226.37	106.78
Shpenzimet e Postave te shpejta	5.50	3.00
Shpenzime Bankare dhe provizione	304.65	72.40
Shpenzime per taksa komunale	-	10.50
Pagat dhe shperblimet e personelit	228,406.51	180,645.70
Sigurimet shoqerore dhe shendetesore	-	9,457.85
SHPENZIMET E KONTRIBUTIT PENSIONAL - PUNËDHËNËSI	11,491.47	-
Shpenzime Derivateve	344.62	-
SHPENZIMET E PASTRIMIT DHE HIGJIENES	-	275.42
SHPENZIMET OPERATIVE	17.12	-
SHPENZIMET E ADMINISTRATËS 18%	959.55	-
SHPENZIMET EKOLOGJIKE	-	10.50
SHPENZIMET PER TAKSA RRUGORE	-	41.00
SHPENZIMET PER TARIFA GJYQESORE	-	200.00
SHPENZIMET E MIREMBAJTJES SE ENRGJIJE	-	11.86
SHPENZIMET PER UJ TE PIJES PER PUNTORET E NDERRMARRJES	315.41	198.31
SHPENZIMET E SIGURIMIT TE MAKINAVE	-	167.92
SHPENZIMET E MIREMBAJTJES SE HOLLIT	-	52.54
SHPENZIMET E MIREMBAJTJES SE VETURAVE ZYRTARE	309.09	21.19
SHPENZIMET E MIREMBAJTJES SE IT	-	235.68
SHPENZIMET E REPREZENTACIONIT TE KE-S	672.59	1,860.68
SHPENZIMET E MIREMBAJTJES SE DYERVE DHE DRITAREVE	-	15.83

SHPENZIMET PER MIREMBAJTJE E WEB FAQES VJETORE ZHVILLIMI	-	338.98
SHPENZIMET PER ANTARSI VJETORE PER KONTABILIST	-	220.00
SHPENZIMET E SANITARIS	463.29	220.66
SHPENZIMET E DERIVATEVE TE VETURES	-	141.71
SHPENZIMET E FOTOKOPJES-PRINTERIT	258.31	-
SHPENZIMET PER SHPALLJE-GAZETA	126.00	118.00
SHPENZIMET E MIRMBAJTJES SE LAURAVE	-	88.72
SHPENZIMET – MIRBAJT.FURN.LAURAT	1,731.51	-
SHPENZIMET PER PROGRAM	1,499.90	-
SHPENZIMET E MIRMBAJTJES SE PROGRAMIT BILANCIT	-	1,241.00
SHPENZIMET PER PROGRAM TE PAGAVE	-	83.90
SHPENZIMET PER DEZINFEKTIM TE HAPSIRAVE TE SAP	271.67	-
SHPENZIMET E MIRMBAJTJES SE ARKAVE FISKALE	170.76	98.73
SHPENZIMET E MIRMBAJTJES TE APARATEVE KUNDER ZJARRIT	12.71	-
SHPENZIMET AD HOC	1.00	-
SHPENZIMET PER TRANSPORT - TAXI	6.20	95.55
SHPENZIMET PER MIRMBAJTJE TE NXEMJES	-	45.36
Shpenzimet paisje IT	85.00	-
SHPENZIMET PËR DHURATA PËR PUNËTORË	50.00	-
MIREMBAJTJE DHE FURNIZIM ME SISTEM TE SHITJES DHE LAURAVE	-	2,597.26
	<b>311,510.86</b>	<b>259,595.47</b>

### 3. Të hyrat për periudhën Janar, Shkurt dhe Mars 2025

Të hyrat janë marrë nga shënimet e kontabilitetit dhe si të tilla po i paraqesim më poshtë:

Përshkrimi	2025
TE HYRAT NGA BILETAT E PERJASHTUARA	57,196.49
TE HYRAT NGA SHERBIMI I BILETAVE	2,130.63
TË HYRAT NGA QERAJA MUJORE UJI	1,328.80
TE HYRAT NGA PARKINGU	81,450.46
TE HYRAT NGA PERONIZIMI	148,802.54
TE HYRAT NGA GARDEROBA	456.78
TE HYRAT NGA TARIFA A1	130.62
TE HYRAT NGA TARIFA A2	4.41
TE HYRAT NGA QERAJA POLIGONIT	635.60
TE HYRAT NGA SHP.KANALIZIMIT	166.10
TE HYRAT E QERASE MUJORE	36,137.18
TE HYRAT E TERASES	469.68
TERASA 1	2,208.32
TERASA 2	700.44
TERASA 3	785.92
TE HYRAT NGA REKLAMAT VJETOE	1,355.93
TE HYRAT NGA NDERRIMI I TARGAVE	63.56
PERONIZIMI MUJOR	1,411.02
QERAJA MUJORE 1	2,037.72
QERAJA MUJORE 2	507.20
HYRJA TEK PERONI	406.78
	<b>338,386.18</b>

### Krahasushmëria e të ardhurave në mes të vitit 2025 /2024

Krahasushmëria e të ardhurave bëhet në periudha të njejta të viteve 2025 / 2024. Të dhënat e të ardhurave janë marrë nga regjistrimet në kontabilitet dhe si të tilla i paraqesim në tabelën më poshtë.

Përshkrimi	2025	2024
TE HYRAT NGA BILETAT E PERJASHTUARA	57,196.49	59,230.50
TE HYRAT NGA SHERBIMI I BILETAVE	2,130.63	2,352.97
TE HYRAT NGA QERAJA MUJORE UJI	1,328.80	1,560.46
TE HYRAT NGA PARKINGU	81,450.46	65,467.80

TE HYRAT NGA PERONIZIMI	148,802.54	157,368.64
TE HYRAT NGA GARDEROBA	456.78	461.02
TE HYRAT NGA TARIFA A1	130.62	190.48
TE HYRAT NGA TARIFA A2	4.41	7.40
TE HYRAT NGA QERAJA POLIGONIT	635.60	635.60
TE HYRAT NGA SHP.KANALIZIMIT	166.10	196.79
TE HYRAT E QERASE MUJORE	36,137.18	35,965.02
TE HYRAT E TERASES	469.68	487.68
TERASA 1	2,208.32	2,190.32
TERASA 2	700.44	700.44
TERASA 3	785.92	785.92
TE HYRAT NGA REKLAMAT VJETOE	1,355.93	1,016.95
TE HYRAT NGA NDERRIMI I TARGAVE	63.56	33.90
PERONIZIMI MUJOR	1,411.02	1,426.69
QERAJA MUJORE 1	2,037.72	2,037.72
QERAJA MUJORE 2	507.20	507.20
HYRJA TEK PERONI	406.78	423.73
SHFRYTEZIM PARKINGU	-	17,309.66
PARKING	-	231.36
SHFRYTEZIM PARKINGU 1	-	228.81
<b>Të hyrat TM1 2025/2024</b>	<b>338,386.18</b>	<b>350,817.07</b>

## Shpalosja e shpenzimeve dhe e të hyrave

**Shpenzimet dhe të hyrat** janë marrë nga Libri Kryesor dhe si të tilla janë paraqitur në formën analitike. Njëkohësisht këto shpenzime dhe të hyra janë paraqitur për periudhën e TM1/2025 dhe TM1/2024 nga e cila është nxjerrë diferenca në mes të vitit 2025 dhe 2024. Nga shpenzimet si në vitin 2025 e po ashtu edhe në vitin 2024 pjesën më të madhe e përbëjnë shpenzimet e pagave prej 239,897.98 € apo 77% të shpenzimeve të përgjithshme të TM1.

Në vitin 2024 shpenzimet e pagave për TM1 kanë qenë 190,103.55 € apo 73% të shpenzimeve të përgjithshme. Në vijim paraqitet tabela për shpenzime të pagave të TM1. Në ngritjen e shpenzimeve të pagave në vitin 2025 ka ndikuar rritja e pagës për 15% për të gjithë punëtorët e ndërmarrjes, rritja e pagës për 10% për zyrtarët e lartë të ndërmarrjes si dhe punësimi i 8 punëtorëve të rinj në ndërmarrje.

<b>Përshkrimi</b>	<b>2025</b>	<b>2024</b>
Pagat dhe shperblimet e personelit	228,406.51	180,645.70
Shpenzimet e kontributit pensional - Punëdhënësi	11,491.47	-

Sigurimet shoqerore dhe shendetesore	-	9,457.85
<b>Totali i shpenzimeve te pagave TM1</b>	<b>239,897.98</b>	<b>190,103.55</b>

**Shpenzimet administrative** - përfshijnë shpenzimet për ujë të pijshëm, shpenzime të fotokopjes, shpenzime të zyrës, shpenzime të postës, shpenzime të sanitarisë, shpenzime për taxi, shpenzime për shpallje-gazeta, shpenzime për udhëtime zyrtare si dhe shpenzime për dezinfektim të hapsirave të Sap. Shpenzimet administrative të TM1 të vitit 2025 janë më të mëdha për 1,623.35€ se sa në vitin 2024 ku shpenzimi që e ka rritur më tepër është shpenzimi për udhëtim zyrtarë e që në vitin 2024 nuk kemi pas shpenzime të tillë. Më poshtë e keni tabelën e shpenzimeve administrative:

<b>Përshkrimi</b>	<b>2025</b>	<b>2024</b>
Shpenzime Zyres	-	313.31
Shpenzime per udhetime zyrtare	1,080.00	-
Shpenzime e postave te shpejta	5.50	3.00
Shpenzimet e administrates 18%	959.55	-
Shpenzimet ekologjike	-	10.50
Shpenzime per taksa rrugore	-	41.00
Shpenzimet per uj te pijes	315.41	198.31
Shpenzime per mirembajtje e web faqes vjetore zhvillimi	-	338.98
Shpenzimet per antarsi vjetore per kontabilist	-	220.00
SHPENZIMET E FOTOKOPJES-PRINTERIT	258.31	-
SHPENZIMET PER SHPALLJE-GAZETA	126.00	118.00
Shpenzimet per dezinfektim te hapsirave te Sap	271.67	-
Shpenzime dhurata per puntore	50.00	-
SHPENZIME PER VENDIME GJYGJSORE	-	200.00
<b>Totali i shpenzimeve administrative TM1</b>	<b>3,066.44</b>	<b>1,443.09</b>

**Shpenzimet operative** – i përbëjnë shpenzimet që kanë punë direkte me operacionet e ndërmarrjes. Në këtë pjesë të shpenzimeve hyjnë shpenzimet e mirëmbajtjes së objektit, shpenzime operative, shpenzime bankare dhe provizione, shpenzime të mirëmbajtjes së laurave, shpenzime për taxi, shpenzimet për program, shpenzimet e mirëmbajtjes së arkave fiskale, shpenzimet e mirëmbajtjes të aparateve kundër zjarrit si dhe matja dhe tokëzimi dhe rrufepritësit. Në vazhdim është tabela që i paraqet shpenzimet operative . Në vitin 2025 shpenzime operative kemi 5,796.30€ , ndërsa në vitin 2024 në TM1 kemi pasur shpenzime operative 7,203.18€ që kemi një diferencë prej 1,406.88€.Kjo diferencë vjen për shkak të furnizimit me sistem të shitjes së laurave .Më poshtë i keni të paraqitura shpenzimet operative të TM1 2025 dhe TM1 2024.

<b>Përshkrimi</b>	<b>2025</b>	<b>2024</b>
Shpenzime te MirMbajtjes Objektit	177.86	42.29
Shpenzime bankare dhe provizione	304.65	72.40
Shpenzimet Operative	17.12	-
Shpenzime e mirmbajtjes se energjise	-	11.86
Shpenzimet e Sigurimit te Makinave	-	167.92
Shpenzimet e Mirmbajtjes se Hollit	-	52.54
Shpenzimet e Mirmbajtjes se veturave zyrtare	309.09	21.19

Shpenzimet e Mirmbajtjes se IT	85.00	235.68
Shpenzimet e Materialit per Zyre	-	99.40
Shpenzimet e reprezentacionit te KE-se	672.59	1,860.68
Shpenzimet e Mirmbajtjes se Dyerve dhe Dritareve	-	15.83
Shpenzimet e derivative te vetures	-	141.71
Shpenzimet e mirmbajtjes se laurave	-	88.72
Shpenzimet Mirmbajt.Furn.Laurat	1,731.51	-
Shpenzimet e sanitarise	463.29	220.66
Shpenzimet per program	1,499.90	-
SHPENZIMET PER TRANSPORT-TAXI	6.20	95.55
Shpenzimet e mirmbajtjes programit Bilanci	-	1,241.00
Shpenzimet per program te pagave	-	83.90
Shpenzimet e Mirmbajtjes se arkave fiskale	170.76	98.73
Shpenzimet e mirmbajtjes te aparateve kunder zjarrit	12.71	-
Shpenzimet e Derivateve	344.62	-
Sgpenzimet per taksa komunale	-	10.50
Shpenzimet Ad Hok	1.00	-
Shpenzimet e mirembajtjes se nxemjes	-	45.36
Mirmbajtja dhe furnizim me sistem te shitjes se laurave	-	2,597.26
<b>Totali i shpenzimeve operative TM1</b>	<b>5,796.30</b>	<b>7,203.18</b>

**Shpenzimet e telefonisë dhe internetit**– Këto shpenzime administrative që në përgjithësi i përkasin shpenzimeve administrative. Në vazhdim kemi tabelën e shpenzimeve:

<b>Përshkrimi</b>	<b>2025</b>	<b>2024</b>
Shpenzimet e telefonit mobil	-	233.49
Shpenzimet e telefonit fiks	-	218.79
Shpenzime Interneti	226.37	106.78
SHPENZIMET E TELEFONIT	389.86	-
<b>Totali i shpenzimeve telefonisë dhe internetit TM1</b>	<b>616.23</b>	<b>559.06</b>

**Shpenzimet e rrymës , ujit dhe mbeturinave** - Shpenzimet e rrymës, ujit dhe mbeturinave për TM1 2025 janë 14,325.01€ ndërsa për 2024 kanë qenë 8,856.74€. Kjo rritje vjen për shkak rritjes së shpenzimeve elektrike dhe mbeturinave .Në vazhdim kemi tabelën e shpenzimeve :

<b>Përshkrimi</b>	<b>2025</b>	<b>2024</b>
Shpenzimet e energjise elektrike	8,257.33	4,948.86
Shpenzimet e pastrimit dhe higjienës	-	275.42
Shpenzimet e nxemjes	-	26.78
Shpenzime Ujit	1,516.85	1,411.61
Shpenzimet e Mbeturinave	4,550.83	2,194.07
<b>Totali i shpenzimeve te ujit, rrymës dhe mbeturinave TM1</b>	<b>14,325.01</b>	<b>8,856.74</b>

**Shpenzimet e biletave të përjashtuara-** Biletat e përjashtuara apo biletat e shitura janë bileta të cilat shiten në sportele të NPL SAP Sha dhe faturohen nga transportuesit për biletat e shitura. Më poshtë është e paraqitur tabela e biletave të përjashtuara:

<u>Përshkrimi</u>	<u>2025</u>	<u>2024</u>
BILETAVE TË PERJASHTUARA	49,808.90	51,429.84

**Të hyrat** - për TM1/25 janë 338,381.94€ ndërsa për TM1/24 kanë qenë 350,817.07€ me një diferencë prej 12,435.12€.

<u>Përshkrimi</u>	<u>2025</u>	<u>2024</u>	<u>Diferenca</u>
TE HYRAT NGA BILETAT E PERJASHTUARA	57,196.49	59,230.50	(2,034.01)
TE HYRAT NGA SHERBIMI I BILETAVE	2,130.63	2,352.97	(222.34)
TE HYRAT NGA QERAJA MUJORE UJI	1,328.80	1560.46	(231.66)
TE HYRAT NGA PARKINGU	81,450.46	65,467.80	15,982.66
TE HYRAT NGA PERONIZIMI	148,802.54	157,368.64	(8,566.10)
TE HYRAT NGA GARDEROBA	456.78	461.02	(4.24)
TE HYRAT NGA TARIFA A1	130.62	190.48	(59.86)
TE HYRAT NGA TARIFA A2	4.41	7.40	(2.99)
TE HYRAT NGA QERAJA POLIGONIT	635.60	635.60	0.00
TE HYRAT NGA SHP.KANALIZIMIT	166.10	196.79	(30.69)
TE HYRAT E QERASE MUJORE	36,137.18	35,965.02	172.16
TE HYRAT E TERASES	469.68	487.68	(18.00)
TERASA 1	2,208.32	2,190.32	18.00
TERASA 2	700.44	700.44	0.00
TERASA 3	785.92	785.92	0.00
TE HYRAT NGA REKLAMAT VJETOE	1,355.93	1,016.95	338.98
TE HYRAT NGA NDERRIMI I TARGAVE	63.56	33.90	29.66
PERONIZIMI MUJOR	1,411.02	1,426.69	(15.67)
QERAJA MUJORE 1	2,037.72	2,037.72	0.00
QERAJA MUJORE 2	507.20	507.20	0.00
HYRJA TEK PERONI	406.78	423.73	(16.95)
SHFRYTEZIM PARKINGU	-	17,309.66	(17,309.66)
PARKING	-	231.36	(231.36)

SHFRYTEZIM PARKINGU 1	-	228.81	(228.81)
	<b>338,386.18</b>	<b>350,817.06</b>	<b>(12,430.88)</b>

**Të hyrat nga qirate-** Të hyrat nga qiratë TM1 të vitit 2025 janë 45,111.99€ ndërsa në vitin 2024 ishin 45,265.03€ . Më posht e keni të paraqitur tabelën:

<b>Përshkrimi</b>	<b>2025</b>	<b>2024</b>	<b>Diferenca</b>
TE HYRA NGA QERAJA MUJORE UJI	1,328.80	1560.46	(231.66)
Tarifa A1	130.62	190.48	(59.86)
Tarifa A2	4.41	7.40	(2.99)
Qera Poligon	635.60	635.60	0.00
Shp. e kanalizimit	166.10	196.79	(30.69)
QERAJA MUJORE	36,137.18	35,965.02	172.16
Terasa	469.68	487.68	(18.00)
Terasa 1	2,208.32	2,190.32	18.00
Terasa 2	700.44	700.44	0
Terasa 3	785.92	785.92	0
Qeraja mujore 1	2,037.72	2,037.72	0
Qeraja mujore 2	507.20	507.20	0
<b>Të hyrat nga qiratë TM1 2025/2024</b>	<b>45,111.99</b>	<b>45,265.03</b>	<b>(153.04)</b>

**Të hyra nga shërbimi,** Të hyrat nga shërbimet paraqesin të hyrat nga shitjet e biletave.Në TM1 2025 kemi një rënje të të hyrave te biletave të perjashtuara prej 2,256.35€ duke e bërë krahasimin me periudhën e njejtë të vitit 2024. Më poshtë e keni të paraqitur tabelën ;

<b>Përshkrimi</b>	<b>2025</b>	<b>2024</b>	<b>Diferenca</b>
BILETAVE TE PERJASHTUARA	57,196.49	59,230.50	(2,034.01)
TE HYRAT NGA SHERBIMI BILETAVE	2,130.63	2,352.97	(222.34)
<b>Të hyrat nga shërbimi i biletave TM1 2025/2024</b>	<b>59,327.12</b>	<b>61,583.47</b>	<b>(2,256.35)</b>

**Të hyrat nga parkingu** – Në të hyrat nga parkingu kemi një rënje prej 1,774.46€. Nga të hyrat e parkingut kemi të bëjmë me të hyrat që parkohen mjetet ,autoshkollat dhe parkingu i autobusëve . Më poshtë e keni të paraqitur tabelën ;

<b>Përshkrimi</b>	<b>2025</b>	<b>2024</b>	<b>Diferenca</b>
TE HYRAT NGA PARKINGU	81,450.46	65,467.80	15,978.42
SHFRYTEZIM PARKINGU	-	17,309.66	(17,309.66)
Hyrja tek peroni	406.78	423.73	(16.95)
PARKING	-	231.36	(231.36)
NDËRRIM I TARGAVE	63.56	33.90	29.66
Shfrytezim Parkingu 1	-	228.81	(228.81)
<b>Të hyrat nga parkingu TM1 2025/2024</b>	<b>81,920.80</b>	<b>83,695.26</b>	<b>(1,774.46)</b>

**Të hyrat peronizimi** – Produkti kryesor në NPL SAP Sha është peronizimi. Të hyrat nga peronizimi kemi një rënie prej 8,581.77€ duke e krahasuar me periudhën e njëjtë të vitit 2024. Më poshtë e keni të paraqitur tabelën ;

<u>Përshkrimi</u>	<u>2025</u>	<u>2024</u>	<u>Diferenca</u>
TE HYRAT NGA PERONIZIMI	148,802.54	157,368.64	(8,566.10)
PERONIZIM MUJOR	1,411.02	1,426.69	(15.67)
<b>Të hyrat nga peronizimi TM1 2025/2024</b>	<b>150,213.56</b>	<b>158,795.33</b>	<b>(8,581.77)</b>

**Të hyra nga WEB faqja reklama** – Në të hyrat nga Web faqja reklama kemi një rritje në vitin 2025 prej 338.98€ në krahasim me vitin 2024. Vlen të theksohet produkti më i ri i NPL SAP Sha është reklama në Web .Ky produkt shfaqet si në vijim:

<u>Përshkrimi</u>	<u>2025</u>	<u>2024</u>	<u>Diferenca</u>
Reklama Vjetore	1,355.93	1,016.95	338.98
<b>Të hyrat nga reklama TM1 2025/2024</b>	<b>1,355.93</b>	<b>1,016.95</b>	<b>338.98</b>

**Të hyra nga garderoba** – Si produkt i veçantë në ndërmarrje është edhe garderoba. Më poshtë e keni të paraqitur tabelën e të hyrave nga garderoba.

<u>Përshkrimi</u>	<u>2025</u>	<u>2024</u>	<u>Diferenca</u>
TE HYRAT NGA GARDEROBA	456.78	461.02	(4.24)
<b>Të hyrat nga garderoba TM1 2025/2024</b>	<b>456.78</b>	<b>461.02</b>	<b>(4.24)</b>

## 5.Pasqyra e të ardhurave TM1/2025 dhe krahasueshmëria me TM1/2024

NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A, Prishtinë

NRF:600118245

NU: 811318741

Pasqyra e të ardhurave gjithëpërfshirëse  
për TM1 që përfundon më 31 Mars 2025

	TM1 2025	TM1 2024
	€	€
Të hyrat	338,386.18	350,817.07
Kostoja e shitjes	(47,808.90)	(51,429.84)
<b>Fitimi/(humbja)bruto</b>	<b>290,577.28</b>	<b>299,387.23</b>
Të ardhurat e tjera		
Shpenzimet e shpërndarjes të pagave	(239,897.98)	(190,103.55)
Shpenzimet administrative	(3,066.44)	(1,443.09)
Shpenzimet e tjera operative	(20,737.54)	(16,619.00)
Shpenzimet e zhvlerësimit	-	-
Fitimet /humbjet tjera - neto	-	-
Të Shpenzime	(263,701.96)	(208,165.64)
<b>Fitimi/(humbja) operativ</b>	<b>26,875.32</b>	<b>91,221.59</b>
<b>Fitimi para tatimit</b>	<b>26,875.32</b>	<b>91,221.59</b>
Shpenzimet e tatimit në fitim	-	-
<b>Fitimi/(humbja)l/e vitit</b>		
<b>Gjithësej të ardhurat/(humbjet)gjithëpërfshirëse të vitit</b>	<b>26,875.32</b>	<b>91,221.59</b>


Pasqyra e të ardhurave paraqet përmbledhjen e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën e njejtë të viteve 2025/2024. Nga kjo del se në vitin 2025 në raportin TM1 kemi një fitim operativ prej 26,875.32€, ndërsa në vitin 2024 në raportin TM1 kemi pasur një fitim operativ prej 91,221.58€. Diferenca në mes të TM1 2025 dhe TM1 2024 është 64,346.26€.

Shpenzimet e zhvlerësimit dhe shpenzimet akruale nuk janë të përfshira në pasqyrën e të ardhurave për periudhën Janar, Shkurt dhe Mars 2025/2024.

Punoi:

Udhëheqëse e shërbimit të Kontabilitetit

Adelina Mustafa



Aprovoi:

U.D Zyrtar Kryesor Financiar:

Fatinda Kongjeli Krasniqi



NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH. A.  
GJP "AUTOBUSKA STANICA" A. D.  
MPE "BUS STATION" J. S.

Nr. 02/3037/A Data 27-10 2025  
No. Data  
PRISHTINE/A

### Shenim shpejgues

Per palet e interesuara,

Ky dokument " Raporti Financiare per periudhen Janar-Shkurt-Mars 2025" eshte punuar ne qershor te vitit 2025 por, per shka te nderrimit te ZKFTH-se dhe ngarkeses administrative, raporti dorezohet me daten 27.10.2025 me nr. protokolli sipas rendijes protokollare te dates 27.10.2025


Pjese e raporti eshte edhe procesverbali i mledhjes se Bordit te Drejtoreve te NPL Stacioni I Autobuseve sh.a i mbajtur me 16.05.2025 me nr. protokolli 02/1062 te dates 20.06.2025 mledhje ne te cilen eshte miratuar raporti Financiare per periudhen Janar-Shkurt-Mars 2025

Fatinda Kongjeli





NPL "STACIONI I AUTOBUSËVE" SH.A. PRISHTINË  
D.P. "AUTOBUSHA STANIQA" A.D. PRISTINA  
MPE "BUS STATION" J.S. PRISTINA



## Procesverbal

Nga Mbledhja e Bordit të Drejtorëve të NPL "Stacioni i Autobusëve" Sh.A. – Prishtinë, mbajtur më datë 16.05.2025 nga ora 11:00 deri në 15:00.

### Të pranishëm në mbledhje:

- z. Pajtim Demaj (PD), Kryesues i BdD,
- znj. Arta Rafuna (AR), Anëtare e BdD,
- znj. Diellza Namani (DN), Anëtare e BdD,
- z. Luan Hoti (LH), Anëtar i BdD,
- z. Veton Prelvukaj (VP), Ushtrues detyre i Kryeshefit Ekzekutiv.

### Të ftuar të tjerë:

- znj. Fatlinda Kongjeli, UD ZKFTH,
- znj. Adelina Mustafa, Udhëheqëse e Kontabilitetit,
- znj. Bedrije Mjeku – Sekretare / Procesmbajtëse.

Mbledhja e BdD-së, e kryesuar nga Kryesuesi z. Demaj, filloi në orën 11:00. Përveç anëtarëve të Bordit, të pranishme ishin edhe znj. Fatlinda Kongjeli, UD ZKFTH, dhe znj. Adelina Mustafa, Udhëheqëse e Kontabilitetit.

Kryesuesi BtD z. Demaj, duke hapur mbledhjen, përshëndeti pjesëmarrësit dhe falënderoi UD ZKFTH dhe udhëheqësen e kontabilitetit për përgatitjen e raportit TMI/2025. Ai theksoi se kjo mbledhje është vazhdimësi e asaj të datës 08.05.2025. Pasi u konstatua se janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Bordit, u propozua rendi i ditës:

### Rendi i ditës:

1. Shqyrtimi i raportit financiar për TMI/2025
2. Të ndryshme

Pas propozimit të Kryesuesit, anëtarët njëzëri e miratuan rendin e ditës, dhe mbledhja vazhdoi me pikën e parë. Fjalën e mori znj. Adelina Mustafa, Udhëheqëse e Kontabilitetit.

Kryesuesi i BtD-ve z. Demaj duke hapur mbledhjen i përshëndeti pjesëmarrësit në këtë mbledhje, dhe falënderoi ZKFTH dhe Udhëheqësen e kontabilitetit për përgatitjen e TMI/2025 ku theksoi se kjo

mbledhje eshte vazhdimisi e mbledhjes se dt.08.05.2025 , pasi konstatoi se në mbledhje janë të pranishëm të gjithë anëtarët e Bordit të Drejtorëve, ai propozoi këtë:

**Rend i ditës:**

1. Shyrtimi i Raportit i financiar për TMI/2025
2. Të ndryshme

Pas propozimit të Kyesusesit, anëtarët/et njëzëri e miratuan rendin e ditës, dhe mbledhja filloi me piken e parë, fjalën e muar zn.Adelina Musatafa Udheheqse e kontabilitetit

➤ **Pika e parë e rendit të ditës:**

**1. Raporti i pasqyrave financiare për TMI/2025**

- 1.1.Udhëheq.Kontb.znj. **Adelina Mustafa:** Kam një konfirmim nga Rihkonti që kemi një diferencë në paga prej 300 €. Nuk ka ndonjë diferencë tjetër.
- 1.2.Kryesuesi BtD z. **Demaj:** Është një ndryshim që e kam vërejtur te kontributet. A është bërë? Te pagat kemi një ndryshim prej 1.51 € dhe një tjetër pagesë prej 251 €.
- 1.3.UD ZKFTH znj. **Fatlinda Kongjeli,** Ka qenë përdorur moduli i vjetër kur ju kemi dërguar raportin. Për tre muaj ka pasur ndryshime – diku 500 €, diku 400 €. Ju premtoj që të gjitha të dhënat e pasqyruara janë të sakta. Nëse dëshironi, mund t'ju dokumentoj çdo shpenzim.
- 1.4.Kryesuesi BtD z **Demaj,** Ju falënderoj për angazhimin dhe punën në përgatitjen e raportit TMI/2025. Që të jetë zyrtar, duhet të kemi të dhëna të sakta dhe në përputhje me gjendjen reale. Nëse dikush dëshiron të diskutojë në detaje, mund ta bëjmë.
- 1.5.Kryesuesi BtD- z. **Demaj,** Kërkoj sqarim lidhur me llogaritjen e pagave dhe shpërblimeve – a janë bruto apo neto?A përfshihen pagesat tjera?
- 1.6.UDZKFTH-znj.Kongjeli: Nuk ka ndryshim për neto dhe për pagesat.
- 1.7.Kryesuesi BtD z **Demaj,**Në rregull, nëse mendoni se është në rregull, te shpenzimet e reprezentacionit kanë qenë 471 €.
- 1.8.UD ZKFTH znj. **Kongjeli,** Janë kthyer në sanitari – secila kontë ka shpenzimin e vet. Ju premtoj që të dhënat në këtë raport janë të sakta.
- 1.9.Kryesuesi BtD z **Demaj,**Nuk po them që të dalë keq, por dua që të dalim korrekt me punën që bëjmë.
- 1.10.Anëtar i BtD z. **Luan Hoti,** I kemi dy raporte për TMI/2025. Njërin vetëm të protokolluar. Propozoj që ai të dërgohet në ZKA për auditim, ndërsa ky aktual të përdoret për nevoja të brendshme. Nuk dua të

bëjmë shkelje – nëse jeni dakord.

1.11. **Kryesuesi BtD z Demaj**, TMI/2025 i dorëzuar në arkiv e konsiderojmë të papranueshëm, sepse nuk është miratuar nga Bordi. Dokumenti është zyrtar vetëm kur përfundon sipas rregullave. Mendoj të vazhdojmë me këtë version aktual. Nuk ka dallime të mëdha. Shtyrja e afatit për miratim nuk është shkelje ligjore. Por aprovimi i një raporti me të dhëna të pasakta është shkelje më e rëndë.

1.12. **UD KE z. Veton Prelvukaj**, Kërkoj sqarim për dallimet – në raportin paraprak kemi pasur më pak shpenzime. Kontoja e shpenzimeve për derivatet është 344 € këtë vit, ndërsa vitin e kaluar nuk kemi pasur. Gjithashtu edhe te shpenzimet administrative.

1.13. **Znj. Mustafa**: Për 300 €, e keni në fund të listës së shpenzimeve për derivatet e veturës zyrtare për vitin 2024. Raportin do ta përgatis me emërtim të qartë për çdo kontë.

1/14. **Kryesuesi i BtD-së z. Demaj**: Atëherë, ju jeni të liruar nga mbledhja dhe ju falënderoj për punën që keni bërë. Pas kësaj, ato u larguan nga mbledhja.

1/15. **Bordi i Drejtorëve** diskutoi rreth krahasueshmërisë së shpenzimeve të pasqyruara në faqen 4 të raportit, si në vijim:

- Shpenzimet e biletave të përjashtuara,
- Shpenzimet e mbeturinave janë të rritura, e njëjta situatë është edhe me shpenzimet e rrymës – andaj kontimi duhet të bëhet në kohën e duhur,
- Shpenzimet për punëtorin në muajin mars 2025,
- Shpenzimet e telefonit, etj.

1/16. **Anëtari i BtD, z. Luan Hoti**, kërkoi të bëhet ndarja e shpenzimeve për telefoninë fikse dhe atë mobile.

1/17. **Anëtarja e BdD-së, znj. Arta Rafuna**, A janë shpenzimet e internetit fikse për çdo muaj?

1/18. **UD KE z. Veton Prelvukaj**, Po, janë fikse çdo muaj.

1/19. **Anëtari i BtD-së, z. Luan Hoti**, Të bëhet edhe ndarja e shpenzimeve të vajit (naftës), për veturat zyrtare dhe për gjeneratorin. Të sqarohet gjithashtu edhe përfshirja e 18% në shpenzimet administrative.

1/20. **Kryesuesi i BdD-së, z. Pajtim Demaj**, kërkoi sqarim lidhur me shpenzimet për mirëmbajtjen e veturave, shpenzimet sanitare, ato administrative, si dhe për fotokopje. A kemi kontratë me kompaninë Rihkont?

1/21. **Kryesuesi i BdD-së, z. Pajtim Demaj**, theksoi se dallimi në përlogaritjen e pagave është për shkak të punësimit të 9 punëtorëve, të cilët nuk kanë qenë të punësuar në vitin paraprak.

1/22. **Bordi i Drejtorëve** kërkoi që **UD ZKFTH** të japë sqarim të saktë lidhur me këto të hyra:

- Te të hyrat nga biletat e përjashtuara ka dallim në krahasim me vitin paraprak.
- Sqarim lidhur me qiratë mujore, ku nuk përfshihen pagesat e borxheve që nuk paraqiten, pasi evidentohen vetëm përmes faturimit dhe jo përmes inkasimit.

**1/23.** Kryesuesi i BtD-së, z. Demaj, pyeti të pranishmit nëse dikush ka diçka për të shtuar lidhur me raportin TMI/2025 në këtë mbledhje. Sa i përket raportit të ardhur në mbledhjen e kaluar më datë 08.05.2025, theksoi se është i papranueshëm, duke i bashkangjitur edhe email-in e Rihkont-it me nr. 02/789, datë 16.05.2025, nga znj. Adelina Mustafa.

**1/24. Bordi i Drejtorëve**, pas diskutimit dhe shqyrtimit të raportit të TMI/2025 të paraqitur nga UD ZKFTH, znj. Fatlinda Kongjeli, me vota të mjaftueshme aprovon raportin në parim, me plotësime dhe ndryshime deri në përfundimin e TMI/2025. Arsyeja e vonësës së afatit kohor për aprovimin e këtij raporti është fakti që Bordi nuk ka pranuar një raport të pasqyrave financiare nga ish-ZKFTH, i cili ka qenë i obliguar ta paraqesë në Bord brenda afatit ligjor me të dhëna të sakta dhe sipas gjendjes reale.

**1/25. UD KE, z. Veton Prevlukaj**, i njoftoi të pranishmit lidhur me kërkesën e aksionarit për pikën që ka të bëjë me raportin e matjes, i cili është në përfundim. Vlerësimi është në proces të kontraktimit dhe do të shërbejë për hartimin e rregullores për qira.

#### ➤ 2.Të ndryshme

**2/1. Bordi i Drejtorëve**, lidhur me çështjet relevante për rishikimin e Planit të Biznesit sipas afatit ligjor, çështjen e rregullores për paga dhe kompensime, rregullores për qira, vendimin për ngritjen e çmimit të qirave, planin dinamik të ndërmarrjes dhe nivelizimin e pagave sipas propozimit të KE-së, propozoi që të organizohet një punëtori. Pas diskutimeve të përgjithshme lidhur me këto çështje konkrete, me vota unanime nga të pranishmit, Bordi i Drejtorëve mori këtë:

### V E N D I M

I.Të organizohet punëtori për shqyrtimin e çështjeve relevante që lidhen me:

- Rishikimin e Planit të Biznesit,
- Planin Dinamik të Ndërmarrjes,
- Rregulloren për Paga dhe Kompensime të tjera,
- për Qira, dhe tema të tjera përkatëse.

II Rregulloren. Punëtorja do të organizohet si vijon:

- Në datën **23.03.2025**, në restorantin "Vila Gërmia" – Prishtinë,
- Në datat **24 dhe 25.05.2025**, në sallën e UD KE-së në ndërmarrje.

III.Të mbulohen shpenzimet për ushqim për pjesëmarrësit në punëtorinë tre (3) ditore.

IV.Bashkangjitur këtij vendimi është lista e nënshkrimeve të pjesëmarrësve në punëtori.

V.Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Shërbimi i Financave dhe Administratës.

---

**2/2. Bordi i Drejtorëve** kërkoi nga menaxhmenti që të dorëzohet kërkesë në KDSS për ndarjen e njësorëve dhe një kërkesë tjetër në Ujësjellësin "Prishtina" për furnizimin me ormatës të ujit.

**2/3. UD KE, z. Veton Prevlukaj**, paraqiti:

- Kërkesën e **Shefit të Sigurimit** për shpalljen e konkursit për një (1) punëtor në sigurim, për shkak të vendit vakant pas pensionimit të një punonjësi,
- Kërkesën nga **Drejtori i Operativës** për katër (4) punëtorë në mirëmbajtje.

**2/4. Bordi i Drejtorëve** miratoi kërkesat e mësipërme për shpalljen e konkurseve për këto pozita. Meqenëse pozitat janë të domosdoshme për funksionimin e kompanisë dhe janë të parashikuara në Planin e Biznesit, Bordi vendosi të mos ketë diskutime shtesë.

**2/5. UD KE, z. Veton Prevlukaj, paraqiti:**

- Një kërkesë për mbulimin e shpenzimeve për një **ekskursion 3-ditor në Shqipëri** për punonjësit,
- Kërkesën nga **Sindikata e Pavarur** me nr. 02/776, datë 15.05.2025, për **ndarjen e mjeteve shtesë** me rastin e **Festës së Kurban Bajramit**.

**2/6. Bordi i Drejtorëve**, në parim, miratoi kërkesën për organizimin e ekskursionit 3-ditor për të punësuarit, por pagesa për pjesëmarrje do të bëhet në përqindje, varësisht nga oferta. Ndërsa kërkesa e Sindikatës për ndarjen e mjeteve shtesë për festën e Kurban Bajramit do të shqyrtohet në një moment tjetër.

#### Lista e detyrave

Që duhet të ndërmerren sipas vendimeve dhe propozimeve të aprovuara në mbledhjen e Bordit të Drejtorëve të datës **16.05.2025**.

N/R	Pika e referencës në procesverbal	Detyrat-obligimet konkrete	Nga kush të kryhet
1.	2/2	Kërkesë për KEDS dhe Ujësjetësin Prishtina	UD Kryeshefi Ekzekutiv
	2/6	Vendim për organizimin e punëtorisë	Sekretaria
	2/4	Vendim për shpalljen e konkursit për punëtor sigurimi dhe punëtor për mirëmbajtje	UD Kryeshefi Ekzekutiv

Meqenëse nga të pranishmit nuk kishte çështje tjera për diskutim, Kryesuesi e shpalli të mbyllur takimin në ora 15:00.

Procesmbajtës-ja  
Bedrije Mjeku

*B.M.*

